

Data 14/07/2026

**PROCESVERBAL – TIPI KONTRATËS – SHËRBIME
(PROCEDURË E HAPUR, MBI KUFIRIN E LARTË MONETAR)
PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “SHËRBIM I TRANSPORTIT “OUTSOURCE I PLOTË”,
PUNONJËSIT HEC FIERZË”.**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Shërbime të tjera-98390000-3.

VLERA E FONDIT LIMIT: 37,060,020 (Tridhjetë e shtatë milion e gjashtëdhjetë mijë e njëzet) lekë pa TVSH ose 395,391 (Treqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e treqind e nëntëdhjetë e një) Euro pa TVSH.

Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 14.07.2026 është 93.73 Lekë/Euro

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar autoriteti/enti kontraktor Korporata Elektroenergjitike Shqiptare, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10.*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi:

Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës” të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, i ndryshuar. Në Nenin 83 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar citohet: “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP i ndryshuar “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet Kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale : me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës Nr. 10.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP i ndryshuar, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se dyfishi i vlerës së përlogaritur të kontratës.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3 e LPP i ndryshuar, si dhe nenin 43 pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në dispozitat e legjislacionit Ligj Nr. 29/2023 PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT (Ndryshuar me aktin normativ nr. 2, datë 7.6.2023; aktin normativ nr. 7, datë 14.12.2023; vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 52, datë 27.6.2024; aktin normativ nr. 4, datë 27.11.2024, ligjin nr. 9/2025, datë 30.1.2025; nr. 81/2025, datë 11.12.2025) (i përditësuar), VENDIM Nr. 211, datë 9.4.2025 PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 922, DATË 29.12.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR DEKLARIMIN E DETYRUESHËM TË DEKLARATAVE TATIMORE DHE TË DOKUMENTEVE TË TJERA TATIMORE, VETËM NËPËRMJET FORMËS ELEKTRONIKE”, UDHËZIM Nr. 24, datë 6.11.2025 PËR DISA SHTESA DHE NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN E PËRGJITHSHËM NR. 26, DATË 8.9.2023, “PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT”, TË NDRYSHUAR.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbime të mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 39 % e fondit limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi:

Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 41, pika 3, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 39 % e vlerës limit të kontratës që prokurohet, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Për Autoritetin Kontraktor KESH sh.a, plotësimi i këtij kriteri është i rëndësishëm pasi shërbimet e mëparshme të ngjashme të realizuara në sektorin publik apo sektorin privat janë kushte të nevojshme që garantojnë se Operatorët Ekonomikë mbi bazën e vlerës së shërbimeve të mëparshme të ngjashme vërtetojnë se zotërojnë kapacitete për të zbatuar me sukses këtë procedure prokurimi.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë profesionale të shoqërisë të vlefshme për transportin e udhëtarëve në zbatim të *Udhëzimit Nr. 5627, datë 18.11.2016 "Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e licencave dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit."*, i ndryshuar.

Argumentimi:

Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4/a, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku pika 4/a citon se : "Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: **licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore**".

Kërkesa që operatori ekonomik të paraqesë licencë profesionale të shoqërisë, të vlefshme për transportin e udhëtarëve, në zbatim të Udhëzimit nr. 5627, datë 18.11.2016, "Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e licencave dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit", i ndryshuar, është vendosur për të garantuar se operatorët ekonomikë që marrin pjesë në procedurën e prokurimit janë të autorizuar ligjërisht për ushtrimin e aktivitetit objekt prokurimi.

Ky kriter është në përputhje me legjislacionin në fuqi për transportin rrugor të udhëtarëve, i cili përcakton se ushtrimi i kësaj veprimtarie lejohet vetëm për subjektet e pajisura me licencën përkatëse të lëshuar nga autoriteti kompetent, sipas kriterëve dhe procedurave të përcaktuara në Udhëzimin nr. 5627, datë 18.11.2016, i ndryshuar.

Paraqitja e kësaj licence shërben për të provuar aftësinë profesionale dhe ligjore të operatorit ekonomik për të realizuar shërbimin e kërkuar, garanton se ai përmbush standardet teknike dhe

administrative të përcaktuara nga legjislacioni sektorial, si dhe minimizon rrezikun e kontraktimit të subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë në kundërshtim me dispozitat ligjore.

Për rrjedhojë, kriteri është objektiv, proporcional dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës, pasi synon të sigurojë që shërbimi i transportit të udhëtarëve të realizohet nga operatorë ekonomikë të licencuar dhe të autorizuar sipas legjislacionit në fuqi.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar Drejtues teknik të shoqërisë i cili të jetë i pajisur me certifikatë kompetence profesionale të lëshuar nga DPSHTRR.

Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklaramit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor, dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklaramit si:

-  Kontratë pune të vlefshme;
-  Çertifikatë Kompetence profesionale të lëshuar nga DPSHTRR;
-  Listëpagesat e shoqërisë formulari E-sig, për periudhën Prill 2026 – Qershor 2026.

Argumentimi:

Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4/b, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku pika 4/b citon se : "Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose".

Kërkesa që operatori ekonomik të ketë të punësuar një Drejtues Teknik të shoqërisë, i pajisur me certifikatë kompetence profesionale të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR), është vendosur për të garantuar se operatori ekonomik disponon kapacitetin profesional dhe organizativ të nevojshëm për administrimin dhe realizimin e shërbimit objekt prokurimi, në përputhje me legjislacionin në fuqi për transportin rrugor.

Drejtuesi Teknik është personi përgjegjës për organizimin, mbikëqyrjen dhe administrimin e veprimtarisë së transportit, duke siguruar që kjo veprimtari të ushtrohet në përputhje me kërkesat ligjore, teknike dhe të sigurisë. Pajisja e tij me certifikatë kompetence profesionale të lëshuar nga DPSHTRR provon se ai zotëron njohuritë dhe kualifikimet profesionale të nevojshme për drejtimin e aktivitetit të transportit rrugor të udhëtarëve, sipas legjislacionit sektorial në fuqi.

Ky kriter synon të garantojë cilësinë, sigurinë dhe vazhdimësinë e ofrimit të shërbimit, si dhe të sigurojë që operatori ekonomik ka personelin kyç të kualifikuar për menaxhimin teknik të kontratës. Kërkesa është

në përputhje me legjislacionin që rregullon transportin rrugor dhe përbën një mjet të domosdoshëm për verifikimin e aftësisë profesionale të operatorit ekonomik.

Për rrjedhojë, kriteri është objektiv, proporcional dhe i lidhur drejtpërdrejt me objektin e kontratës, pasi synon të sigurojë që shërbimi të realizohet nga operatorë ekonomikë që disponojnë personel drejtues të kualifikuar dhe të certifikuar nga autoriteti kompetent.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar për periudhën Prill 2026 – Qershor 2026 minimalisht 3(tre) drejtues mjeti.

Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklaramit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor, dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklaramit si:

Për drejtuesit e mjeteve të paraqiten:

-  Kontratë pune të vlefshme;
-  Leje drejtimi automjeti e klasit D të vlefshme;
-  Listëpagesat e shoqërisë formulari E-sig, për periudhën Prill 2026 – Qershor 2026

Argumentimi:

Kërkesat për punonjësit, janë kërkuar në bazë të pikës 4, të nenit të 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku me anë të këtij kriteri vërtetohet që operatorët ekonomikë dëshmojnë se kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit. KESH sh.a, duhet të ketë besueshmërinë dhe të kërkojë garanci për realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi, duke përfshirë kërkesat për një staf të kualifikuar.

Kërkesa që operatori ekonomik të ketë të punësuar, për periudhën Prill 2026 – Qershor 2026, minimalisht 3 (tre) drejtues mjeti, është vendosur në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës, si dhe lidhet drejtpërdrejt me objektin e prokurimit. Duke qenë se për realizimin e kontratës kërkohet disponimi i minimalisht 3 (tre) automjeteve, është e domosdoshme që operatori ekonomik të disponojë edhe numrin përkatës të drejtuesve të mjeteve, me qëllim garantimin e realizimit të shërbimit në mënyrë të vazhdueshme, të rregullt dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor. Çdo automjet duhet të ketë drejtuesin përkatës, i cili do të sigurojë operimin e tij gjatë zbatimit të kontratës. Kërkesa për të paktën 3 (tre) drejtues mjeti është proporcionale dhe nuk tejkalon nevojat reale të kontratës, pasi korrespondon me numrin minimal të automjeteve të kërkuara për realizimin e shërbimit. Ky kriter synon të garantojë që operatori ekonomik disponon burimet njerëzore të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, duke shmangur ndërprerjet ose pamundësinë e ofrimit të shërbimit për shkak të mungesës së personelit. Për rrjedhojë, kriteri është objektiv, proporcional dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës, pasi siguron që operatori ekonomik ka kapacitetin e nevojshëm njerëzor për të realizuar shërbimin në përputhje me kërkesat e dokumenteve të tenderit dhe legjislacionin në fuqi.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të disponojë minimalisht 3(tre) automjete me karakteristikat e mëposhtme:

1(një) autobus 45+1 vende, vit prodhimi minimalisht 2010, Euro 5 dhe kondicionim

1(një) autobus 35+1 vende, vit prodhimi minimalisht 2010, Euro 5 dhe kondicionim

1(një) minibuz 16+1 vende, vit prodhimi minimalisht 2010, Euro 5 dhe kondicionim

Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklaramit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor, dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklaramit si:

Si dëshmi për të vërtetuar dispononim e 3(tre) automjeteve për transportimin e punonjësve, Operatori ekonomik ofertues do të paraqesë këto dokumente:

-  Dokumentacion për mjetin në pronësi, ose me qera, ose me huapërdorje (fatura blerje/dokumente zhdoganimi / kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / kontratë dhurimi / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).
-  Dokument që vërteton regjistrimin e mjetit (Leje qarkullimi),
-  Çertifikatë të kontrollit teknik të mjetit të vlefshëm,
-  Siguracion të mjetit të vlefshëm,
-  Çertifikatë transporti,
-  Akt vlerësimi i plotësimit të kushtëve komode të vlefshëm.

Argumentimi:

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Kërkesa që operatori ekonomik të disponojë minimalisht 3 (tre) automjete, konkretisht:

- 1 (një) autobus me kapacitet 45+1 vende, vit prodhimi minimalisht 2010, standard minimal Euro 5 dhe i pajisur me sistem kondicionimi;
- 1 (një) autobus me kapacitet 35+1 vende, vit prodhimi minimalisht 2010, standard minimal Euro 5 dhe i pajisur me sistem kondicionimi;
- 1 (një) minibus me kapacitet 16+1 vende, vit prodhimi minimalisht 2010, standard minimal Euro 5 dhe i pajisur me sistem kondicionimi,

është vendosur në funksion të realizimit të plotë dhe cilësor të shërbimit objekt prokurimi, duke garantuar që operatori ekonomik disponon kapacitetet teknike të nevojshme për përmbushjen e kontratës.

Numri dhe lloji i automjeteve janë përcaktuar mbi bazën e nevojave konkrete të autoritetit kontraktor, duke marrë në konsideratë numrin e pasagjerëve që do të transportohen, destinacionet, frekuencën e lëvizjeve dhe nevojën për fleksibilitet në organizimin e shërbimit. Kërkimi i dy autobusëve me kapacitete të ndryshme dhe një minibusi mundëson përmbushjen e kërkesave të transportit në situata të ndryshme, duke siguruar përdorimin e mjetit të përshtatshëm sipas numrit të udhëtarëve dhe nevojave operative.

Kërkesa që automjetet të jenë prodhim jo më të hershëm se viti 2010 dhe të përmbushin standardin minimal Euro 5 synon të garantojë përdorimin e mjeteve që ofrojnë një nivel të lartë sigurie, besueshmërie teknike dhe reduktimi të emetimeve ndotëse, në përputhje me standardet mjedisore dhe kërkesat për mbrojtjen e mjedisit. Po ashtu, kërkesa për pajisjen e automjeteve me sistem kondicionimi lidhet drejtpërdrejt me sigurimin e komoditetit dhe cilësisë së shërbimit për pasagjerët gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës. Ky kriter është objektiv, proporcional dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës, pasi nuk tejkalon nevojat e autoritetit kontraktor, por synon të garantojë që operatori ekonomik disponon mjetet e nevojshme, të sigurta dhe teknikisht të përshtatshme për realizimin e shërbimit të transportit të udhëtarëve në mënyrë të rregullt, të pandërprerë dhe në përputhje me kërkesat e dokumenteve të tenderit.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë Çertifikatat ISO ose ekuivalentet e tyre, në përputhje me objektin e prokurimit, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, si më poshtë:

 SSH / ISO 9001: “Sistemi i menaxhimit të cilësisë”

 SSH / ISO 14001: “Sistemi i menaxhimit të mjedisit”

Argumentimi:

Ky kriter u vendosën në përputhje me parashikimin e nenit 36 dhe nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si dhe nenit 44, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe Ligjit Nr. 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, ku përcaktohet se këto Çertifikata duhet të jenë të lëshuara nga organizma certifikues të akredituar, me qëllim që enti prokurues të krijojë sigurinë që operatorët ekonomik ofertues i kanë kapacitetet teknike lidhur aftësinë e tyre për të kryer shërbimin objekt kontrate.

Kërkesa që operatori ekonomik të paraqesë certifikatat SSH / ISO 9001: "Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë" dhe SSH / ISO 14001: "Sistemi i Menaxhimit të Mjedisit", ose ekuivalentet e tyre, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, është vendosur në përputhje me natyrën dhe kompleksitetin e objektit të prokurimit, me qëllim garantimin e cilësisë së shërbimit dhe respektimit të standardeve mjedisore gjatë ekzekutimit të kontratës.

Kërkesa për certifikatën SSH / ISO 9001: synon të provojë se operatori ekonomik zbaton një sistem të standardizuar të menaxhimit të cilësisë, i cili garanton planifikimin, organizimin, monitorimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të proceseve të punës, duke siguruar ofrimin e shërbimit të transportit në mënyrë të qëndrueshme, të kontrolluar dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor.

Kërkesa për certifikatën SSH / ISO 14001: synon të sigurojë që operatori ekonomik administron veprimtarinë e tij në përputhje me standardet ndërkombëtare të menaxhimit mjedisor, duke kontrolluar ndikimin e aktivitetit të transportit në mjedis, duke respektuar kërkesat ligjore në fuqi dhe duke ndërmarrë masa për reduktimin e ndotjes dhe përmirësimin e performancës mjedisore.

Paraqitja e këtyre certifikatave ose ekuivalenteve të tyre përbën një mjet të përshtatshëm për të verifikuar kapacitetin organizativ të operatorit ekonomik për të ofruar një shërbim cilësor, të besueshëm dhe në

përputhje me standardet ndërkombëtare të menaxhimit. Kërkesa nuk kufizon konkurrencën, pasi pranohet edhe paraqitja e certifikatave ekuivalente, të lëshuara nga organe të akredituara sipas legjislacionit në fuqi.

Shënim: Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Në rast të ofertave nga ofertues të huaj, dokumentet e ofertës duhet të jenë ekuivalente me dokumentet e kërkuara sipas parashikimeve ligjore të fushës për njehsimin e dokumenteve.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike:

Specifikimet teknike janë hartuar nga Grupi i punës (sipas procesverbalit pjesë integrale e kësaj procedure) ku në të citohet se:

Ky proces verbal mbahet referuar nevojës për shërbimin e transportit të punonjësve HEC Fierzë, i cili është një nevojë e vazhdueshme dhe e domosdoshme për garantimin e mbarrëvajtjes së aktivitetit të punës në këtë Njësi Prodhuese. Aktiviteti në HEC Fierzë ushtrohet në një zonë ku një pjesë e konsiderueshme e punonjësve e kanë të nevojshëm transportin e organizuar për të siguruar prezenën në punë sipas orareve zyrtare si më poshtë:

- Personeli ditor Administrativ, Nr. i punonjësve për transport = 78 persona. Programi ditor do të fillojë në ora 7:30 nga Bajram Curri Qender dhe kthimi në ora 16:30 nga HEC Fierzë Qendër, nga e Hëna deri të Premten. Ditët e Shtuna, të Dielat dhe festat zyrtare janë pushim.
- Personeli me turne dhe gatishmëri të HEC Fierzë. Nr. i punonjësve për transport = 14 persona me program ditor si në vijim:
- Nisja nga Bajram Curri Qender ora 7:00 – Mbërritja në HEC Fierze Vepra e marrjes 7:30. Marrja e 14 punonjësve të turnit të mëparshëm dhe kthimi në Bajram Curri Qender.
- Nisja nga Bajram Curri Qender ora 18:00 – Mbërritja në HEC Fierzë Vepra e marrjes në 18:30. Marrja e 14 punonjësve të turnit të mëparshëm dhe kthimi në Bajram Curri Qender.
- Transporti i punonjësve në çdo moment që kërkohet për situata emergjente, siç janë permbytje, avari, etj., duhet të jetë në dispozicion të autoriteteve përkatëse. Furnizuesi duhet të jetë në gjendje të kryejë transportin në kushtet e emergjencave në çdo moment.

Ofrimi i këtij shërbimi ndikon drejtpërdrejt në vijueshmërinë e proceseve operacionale dhe në realizimin e objektivave të shoqërisë KESH sh.a.

Grupi i Punës hartoj Termat përkatëse të Referencës të nevojshme për kryerjen e kësaj procedure të cilat janë hartuar duke marrë në konsideratë nevojën për vazhdimësinë e shërbimit të transportit për punonjësit e HEC Fierzë. Për këtë objekt prokurimi, duke përllogaritur sasitë e nevojshme, karakteristikat e duhura si dhe domosdoshmërinë e kryerjes së kësaj procedure.

Njësia e Prokurimit